



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: LETËRSI KLASIKE

Pedagogu: Arta Sula
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: bachelor
Viti/Semestri: I/II

EKSTRAKT

Letërsia klasike zë një vend të rëndësishëm për njohjen dhe studimin e qytetërimit klasik greko-romak. Kjo lëndë, e ndarë në letërsi greke e letërsi romake, bazohet në bindjen se studimi i letërsisë përbën një faktor të rëndësishëm për autokoshiencën e botës aktuale. Përmes kësaj letërsie autorët antikë shprehën tensionin konceptual dhe artistik i cili qëndron në themel të energjisë së jashtëzakonshme dinamike të qytetërimit klasik.

Etapa themelore ku do të ndalemi në letërsinë greke janë : mentaliteti epik, individualizmi dhe subjektivizmi i poezisë lirike, kerkimi dhe etja për dituri, shpikja e teatrit, kategoria e historisë. Pas gjithë kësaj serie zbulimesh intelektuale do të vazhdojmë me fazën jo më pak të rëndësishme të Helenizmit, gjatë së cilës bëhet një sistemim organik i kesaj trashëgimie të tërë.

Mendojmë, së fundi, t'i kushtojmë kohë edhe epokës kur Greqia u përfshi në perandorinë e Romës, kur kultura e saj pati si qëllim të transmetojë jo vetëm një trashëgimi të jashtëzakonshme dijesh dhe arti, por mbi të gjitha idealet që e kishin frymëzuar atë e kështu, vitaliteti i kësaj kulture do të mund të furnizonte instrumentet doktrinale dhe shprehese për mesazhin e ri të krishterë, i cili do t'i jepte një kthesë themelore të gjithë qytetërimit.

Pas trajtimit të këtyre çështjeve do të vazhdojmë me letërsinë romake ku fillimisht do të shohim fillimet e hershme të kesaj letërsie në poezi e prozë. Pas periudhës arkaike do të ndalemi në epokën e Çezarit, kryesisht në zhvillimet e oratorisë dhe historisë, në figura si Ciceroni, Çezari.

Një vend të veçantë do t'i kushtohet lirikës, me Katulin, Tibulin dhe Ovidin. Ishin pikërisht këta tre autorë që i dhanë gjuhës latine, deri në atë moment e karakterizuar nga një ton i përshtatshëm për ligjërata e tekste legjislativë, butësinë elastike të një idiomë të plazmuar për të kënduar gëzimet dhe vuajtjet e dashurisë.

Më pas do të ndalemi në epokën e Augustit për t'u njohur me disa karakteristika të elegjisë latine. Mendojmë ta mbyllim me këta autorë : Propertin, Tibulin, Virgjinin, Horacin dhe Ovidin.

TEMAT:

LEKSION 1. Kultura greke dhe transmetimi i saj.

LEKSION 2. Letërsia e epokës arkaike. Poezia epike dhe didaskalike. Poemat homerike.

LEKSION 3. Poezia lirike. Arkiloku, Safo, Anakreonti, Ibiku.

LEKSION 4. Letërsia e shek. V. Tragjedia. Eskili, Sofokliu, Euripidi.

LEKSION 5. Komedia antike. Aristofani dhe dramaturgjia e tij.

LEKSION 6. Letërsia e shek. IV. Menandri dhe komedia e “re”.

LEKSION 7. Letërsia e epokës helenistike. Kalimaku, Apolon Rodi, Teokriti.

LEKSION 8. Letërsia e epokës perandorake. Letërsia hebraike dhe e krishterë në gjuhën greke.

LEKSION 9. Fillimet e letërsisë romake, periudha arkaike, poezia, proza.

LEKSION 10. Epoka e Çezarit. *I Commentarii de bello Gallico. I Commentarii de bello civili.*

LEKSION 11. Katuli dhe poezia e dashurisë në *Liber*.

LEKSION 12. Doktrina e Epikurit dhe përhapja e saj në Romë. Lukreci.

LEKSION 13. Epoka e Augustit dhe organizimi i kulturës. Rrethi i Mecenatit.

LEKSION 14. Virgjili dhe veprat e tij. *Bukoliket, Gjeorgjiket dhe Eneida.*

LEKSION 15. Ovidi. Jeta dhe vepra.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

LITERATURA:

1. LEKSIONE TË POSAÇME PËR LËNDËN

2. Muzafer Xhaxhiu. *Letërsia antike greke.*

3. Muzafer Xhaxhiu. *Letërsi antike romake.*

4. Bruno Franchi. *Cesare, Catullo, Tibullo, Properzio, Ovidio.* Antologia dalle opere. Casa editrice G. D'Anna, Messina – Firenze.